



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1697/Prot.

Tiranë, më 26.02.2026

UDHËZIM

Nr. 4, datë 26.02.2026

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 3.5.2024 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT "MËSUES PËR SHQIPËRINË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe urdhrin nr. 578, datë 11.11.2025, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani".

**U D H Ë Z O J:**

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:
  - a) Kudo në udhëzim togfjalëshi "Ministria e Arsimit dhe Sportit" dhe akronimi "MAS" të zëvendësohen me fjalët "Ministria e Arsimit" dhe "MA".
  - b) Pika 3, e Kreut I, ndryshon si më poshtë:

"3. Portali "Mësues për Shqipërinë" krijohet për punësimin e mësuesve në arsimin parauniversitar bazuar në meritë, transparencë, shanse të barabarta dhe në planifikimin me efikasitet të burimeve njerëzore".
  - c) Pika 5, e Kreut III, ndryshon si më poshtë:

"5. Kandidati aplikon në DRAP-në ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në tri ZVAP ku dëshiron të punësohet. brenda DRAP-it ku ka vendbanimin e përhershëm".
  - ç) Në pikën 12, të kreut IV pas togfjalëshit "të të gjitha profileve" të shtohet togfjalëshi "brenda të njëjtit DRAP".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet

arsimore rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

*Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

